

FJALA E DEPUTETES ENSLEMVERA ZAKE

E ENJTE 12 MAJ 2022

E nderuar Kryetare e Kuvendit,

Të nderuar kolegë,

Sa i takon veprimtarisë dhe vlerësimit të Autoritetit të Konkurrencës gjatë vitit 2021, fillimisht do të doja t'ju paraqisja një informacion të përmbledhur në lidhje me veprimtarinë e këtij institucioni, si dhe disa rekomandime për vitin në vazhdim. Qëllimi kryesor i aktivitetit të Autoritetit të Konkurrencës, siç parashikohet edhe në ligjin nr. 9121, datë 28.7.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", të ndryshuar", është mbrojtja e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, duke u mbështetur në tri shtylla kryesore që përcaktojnë mbrojtjen e konkurrencës: abuzimin me pozitën dominuese, mbështetjen e ndaluar në formën e karteleve dhe bashkëpunimin ose përqendrimet e ndërmarrjeve, si dhe të gjithë kuadrin ligjor që rregullon aktivitetin e institucionit të pavarur në Republikën e Shqipërisë.

Veprimtaria e institucionit të Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2021 është bazuar në prioritetet e vetë institucionit, rekomandimet e Kuvendit të Shqipërisë, problematikat e evidentuara në mjetet e informimit publik apo edhe nga ankesat e depozituara, sipas përcaktimeve ligjore, duke u përmbledhur në miratimin total të një numri vendimesh, rreth 93, realizimin e 12 monitorimeve të tregjeve specifike, nga ku 7 monitorime kanë filluar që në vitin 2020, vlerësimin e 42 rasteve të kontrollit të përqendrimeve, nga të cilat komisioni ka vlerësuar, klasifikuar dhe ka autorizuar 31 raste dhe nuk ka klasifikuar 11 raste, si dhe vlerësimin ligjor të 36 projektakteve nënligjore. Në vlerësimin e Komisionit për Ekonominë dhe Financat puna e kryer nga Autoriteti i Konkurrencës për vitin 2021, ka rezultuar në përmbushje të kërkesave të rezolutës së mëparshme të Kuvendit.

Gjithashtu, komisioni shprehu edhe angazhimin për rritjen e bashkëpunimit me Autoritetin, duke ofruar mbështetjen e tij maksimale ndaj këtij institucioni, i cili na siguron një informacion mjaft të vlefshëm se ku shteti duhet t'i kryejë ndërhyrjet e veta dhe ku duhet të ruajë balancat. Komisioni u mbledh për të shqyrtuar draftin e rezolutës së përgatitur, e cila pasqyron të dhënat e raportuara për aktivitetin e Autoritetit, si dhe çështjet e diskutuara në seancat dëgjimore që i kemi zhvilluar në datën 13 prill. Komisioni shqyrtoi edhe propozimet e opozitës, e cila vendosi mosmiratimin e tyre për disa çështje, pasi paraqitnin qëndrime politike dhe jo objektive.

Lidhur me projektrezolutën, kërkohet që Autoriteti i Konkurrencës për vitin 2022 të angazhohet veçanërisht në këto drejtime: Të orientohet drejt digjitalizimit të proceseve të monitorimit dhe hetimit të tregjeve, si dhe të implementojë sa më parë projektin për digjitalizimin e arkivit dhe protokollit të Autoritetit. Të nxisë komunikimin me publikun në tërësi, nëpërmjet publikimit të “News letters” të Autoritetit. Të përmirësojë treguesit e transparencës për vendosjen në dispozicion të qytetarëve të një kategorie më të gjerë të informacionit. Të angazhojë kapacitetet administrative të institucionit për intensifikimin e monitorimit dhe përfundimit në një kohë të arsyeshme të procedurave hetimore jo vetëm në tregjet sensitive dhe me impakt të drejtpërdrejtë për mirëqenien e konsumatorit, por edhe në tregjet e tjera, referuar rekomandimeve të BE-së dhe OECD-së, si dhe tregun e tregtimit të vajit vegjetal, tregun e tregtimit të karburanteve, tregun e shërbimeve të telefonisë celulare, barnave dhe pajisjeve mjekësore.

Të mbajë në monitorim përqendrimin e autorizuar në tregun e telefonisë celulare, me qëllim vlerësimin e efekteve që do të sjellë në treg ndryshimi i kontrollit të shoqërive respektive. Të përfshijë sa më parë ndryshimet në rishikimin e ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencën”, të ndryshuar” në proceset e konsultimit me publikun, me qëllim paraqitjen e tyre në Kuvend brenda vitit 2022. Të angazhojë kapacitetet e tij administrative për adresimin e rekomandimeve cilësore për entet rregullatore dhe institucionet e administratës qendrore, si dhe në pasurimin e platformës online me këto rekomandime, duke përditësuar statusin e tyre në vazhdimësi. Të përfshihet më shumë në advokacinë e rekomandimeve dhe reformave që promovojnë konkurrencën në procedurat e prokurimit publik, si dhe të organizojë tryeza për bashkësitë e biznesit, në mënyrë që të sigurohet konkurrenca në procedurat e prokurimit publik.

Të fokusohet në promovimin e mëtejshëm të kulturës së konkurrencës dhe komunikimin e vazhdueshëm me biznesin, si dhe të intensifikojë marrëdhëniet me botën akademike për çështjet e rregullimit të tregut, me qëllim sigurimin e njohurive të nevojshme për shumë profesionistë në fushën e ligjit të konkurrencës. Të bëjë vlerësimin ligjor dhe të japë asistencën e nevojshme për ndihmën shtetërore për plotësimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor, si dhe të bëjë vlerësime për rastet e dhënies së ndihmës ligjore kur ka shqetësime për konkurrencën. Të angazhohet në organizimin e takimeve periodike me sipërmarrjen dhe botën akademike për të ndarë eksperiencat më të mira për parimet dhe kuadrin rregullator të konkurrencës. Të bashkëpunojë me institucionet homologe të BE-së për të huazuar praktikën më të mira në fushën e konkurrencës dhe të sigurojë asistencën e ekspertëve ndërkombëtarë për çështjet me rëndësi.

Gjithashtu, Kuvendi dhe ne si komision, në draftrezolutën që kemi sjellë sot për miratim kemi rekomanduar që organet ekzekutive të të gjitha niveleve të bashkëpunojnë me Autoritetin e Konkurrencës, ashtu siç u shpreh edhe relatorja, paraprakisht në vlerësimin e opinioneve nga ana e Autoritetit të Konkurrencës për çdo projektligj apo akt normativ që do të miratohet, si dhe përfshirjen e Autoritetit të Konkurrencës në konsultime të përhershme në procesin e përgatitjes dhe miratimit të akteve ligjore dhe nënligjore për të siguruar një konkurrencë sa më të mirë dhe efektive në treg. Ju faleminderit!